

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ANCHOR BETON” SH.P.K

Në cilësinë e “Ortakëve Themelues”

1) Shoqëria **ANCHOR INVESTMENTS sh.p.k.**, person juridik shqiptar, regjistruar në Q.K.B., me NIPT: L71421016I, me seli në Tiranë, Rruga “*Ibrahim Rugova*”, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019, përfaqësuar nga Administratori **z. Albi Shyti**, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal J11110084P, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

dhe

2) Shoqëria **J - COILS sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar në Q.K.B., me NIPT: L51608037P, me seli në Tiranë, Bërxull, Rruga “*Aeroporti*”, Qaf Kashar - Rinas, Km. 3, Magazina nr. 40, me përfaqësues ligjor **z. Jak Bushi**, shtetas shqiptar, lindur në Kçirë - Pukë, më 20.10.1957, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal F71020139G, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, i ndryshuar, si dhe në Aktin e Themelimit të përpiluar dhe nënshkruar prej tyre, më datë 02.12.2020, Ortakët kanë themeluar shoqërinë me emërtimin “ANCHOR BETON sh.p.k.” (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, i ndryshuar, në të nënshkruarit shpallim si më poshtë:

KREU I

FORMIMI, AKTIVITETI DHE ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Formimi i Shoqërisë

1.1 Formohet shoqëria “ANCHOR BETON” sh.p.k.

1.2 Shoqëria është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, SH.P.K., dhe Zotërohet nga Ortakët:

- Shoqëria **ANCHOR INVESTMENTS sh.p.k.**, person juridik shqiptar, regjistruar në Q.K.B., me NIPT: L71421016I, me seli në Tiranë, Rruga “*Ibrahim Rugova*”, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019, përfaqësuar nga Administratori **z. Albi Shyti**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më 10.11.1991, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal J11110084P, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

dhe

- Shoqëria **J - COILS sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar në Q.K.B., me NIPT: L51608037P, me seli në Tiranë, Bërxull, Rruga “*Aeroporti*”, Qaf Kashar - Rinas,

Km. 3, Magazina nr. 40, me përfaqësues ligjor **z. Jak Bushi**, shtetas shqiptar, lindur në Kçirë - Pukë, më 20.10.1957, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal F71020139G, madhor e me zotësi te plotë juridike dhe për të vepruar.

Neni 2

Forma Juridike

- 2.1 Shoqëria "ANCHOR BETON" sh.p.k. është person juridik i së drejtës shqiptare.
- 2.2 Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.
- 2.3 Shoqëria pasi të ketë fituar personalitet juridik është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.
- 2.4 Shoqëria "ANCHOR BETON" sh.p.k. është një shoqëri, kapitali i së cilës është ndarë në kuota dhe që themelohet nga Ortakët që mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën:

- Tiranë, Rruga "Ibrahim Rugova", Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019.

- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë lirisht vendndodhjen e zyrës qendrore të saj, si dhe të çelë degë apo zyra përfaqësimi kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 4

Kohëzgjatja e Veprimtarisë Ekonomike

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Vula

- 5.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.
- 5.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Administratori në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Objekti i Shoqërisë

Në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

"Ndërtim i objekteve civile dhe industriale, rrugëve, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, tunele, vepra turistike, bujqësore, ndërtimi i ndërtesave, zyrave, porteve, aeroporteve, veprave energjetike, ujësjellësa dhe kanalizimeve, kulla, kulla uji, gurore, veshje fasadash, pastrim të sipërfaqes urbane, prodhim inertesh, shfrytëzim e përpunim i materialeve të shtratit të lumenjve si edhe çdo veprë tjetër me qëllim ndërtimi. Përfshihen edhe kompletimet me instalimet e nevojshme, riparimet dhe restaurimet e këtyre objekteve. Prodhim, përpunim, shitje dhe blerje betoni. Ndërtim i linjave dhe fabrikave për prodhimin e materialeve të ndërtimit, të inerteve, soletave të pararendura, tullave, tjegullave, pllakave majolike, tregtim e transport i tyre. Ndërtim rrugësh, veprash e objekteve infrastrukturore të kategorive të ndryshme duke përfshirë veshje me asfalto beton dhe sistemi asfaltimi. Promovimin dhe realizimin e investimeve dhe punimeve ndërtimore të të gjitha kategorive,

duke përfshirë por pa u kufizuar në punime ndërtimore si punime dheu, gërmime, pastrime, sistemime, tarracime terrenesh, etj. Prodhim material inerte, rërë, çakëll, gurë, mermere, etj. Prodhim elementesh të parafabrikuara, betoni e beton arme. Import, eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë apo të tretëve të materialeve të ndërtimit, produkteve industriale, makinerive, pajisjeve e pjesë këmbimi të tyre, lëndëve të para, produkteve të gatshme e gjysëm të gatshme, mineraleve. Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të skrapit dhe metaleve me ngjyra. Transport kombëtar e ndërkombëtar në rrugë detare, tokësore, apo ajrore të të gjitha llojeve të mallrave të lejuara nga legjislacioni shqiptar dhe të huaj në fuqi. Shitblerjen dhe riparimin e pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit dhe mjeteve rrugore për nevojat e shoqërisë dhe të të tretëve. Blerja dhe shitja e automjeteve të reja e të përdorura Kërkim, zbulim mineralesh, hapje dhe shfrytëzim minierash, pasurime industriale të minierave, mbyllje punimesh dhe rehabilitim ambjenti në minierat e shuara ose të konservuara, ndërtim impiante fraksionimi e betoni, si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër lidhur me karriera të çdo lloj tipi dhe cilësie në Republikën e Shqipërisë. Punime me lëndë plasëse në objekte infrastrukturore, ndërtimore e minerare. Konsulencë në fusha të ndryshme, supervizion, menaxhime, studime e projektme të të gjitha llojeve, vleresime tekniko - ekonomike, konsulencë dhe ndërmjetësim për lidhje dhe zbatim kontratash, marrëveshesh të ndryshme, ortakërisht, shoqërishtë të përbashkëta apo forma të tjera, veprimtari komisionere, përfaqësim, si dhe veprime të tjera të porositura nga të tretët të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Konsulencë, revizion, ekspertizë, vleresime të kapitaleve dhe gjendjes së shoqërive, planbiznese, projekte zhvillimi dhe studime të efektiviteteve ekonomike, përcaktimi i prioriteteve në fusha të ndryshme të ekonomisë etj., administrim fondesh dhe/ose investimesh etj. Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe /ose të pjesëve përbërëse të saj, për shfrytëzimin njerëzor me karakter pushues, argëtues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe më gjerë. Tregtimin, dhënien e marrjen me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të veta ose të të tretëve, edhe të mobiluara, etj. Ndërmjetësim në të gjitha fushat e sektopret ekonomik të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në fushën e mjedisit shoqëria do të kryejë: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër, trajtimi i ujrave industrial, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kënetave si dhe çdo veprimtari tjetër mjedisore që ka rëndësi për shoqërinë. Në fushën e telekomunikacionit shoqëria do të kryejë: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin e impianteve të telekomunikacionit dhe shërbimet e ndërlidhjes në internet, administrimi, vendosja dhe përdorimi i impianteve fikse dhe të lëvizshme për transmetime radiotelevizive e mjete të tjera komunikimi. Shoqëria ka të gjitha të drejtat për të marrë pjesë në fitimet dhe/ose në shoqëri të tjera të së drejtës shqiptare ose të shteteve të tjera dhe të themelojë e të kryej çdo tjetër veprim juridik të njohur nga legjilacioni në fuqi me shoqëri të tjera, me persona fizikë ose juridikë, publik ose privat, vendas ose të huaj. Gjithashtu, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj shërbimi apo aktiviteti ndërtimi, tregtar, financiar, konsulencë, qiradhënës apo dorëzanës, që i lejohet një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj”.

Neni 7 Aktiviteti i Shoqërisë

7.1 Kryerja e çdo aktiviteti që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

7.2 Për realizimin e objektit të saj, shoqëria mund të ndër marrë dhe zhvillojë, e vetme apo në bashkëpunim me shoqëri, sipërmarrje të tjera, ente publike e private, çdo lloj aktiviteti me qëllim tregtar, financiar, dorëzanës etj., që e vlerëson të dobishëm apo të nevojshëm për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj.

7.3 Shoqëria mund të blejë e të shesë kuota, apo aksione në shoqëri të treta, të kryejë aktivitete bashkimi, ndarje, përthithje drejtpërdrejt apo nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj si dhe të marrë pjesë në bashkime me shoqëri të tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme.

7.4 Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 8 Kapitali i Shoqërisë

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 Euro (një milion euro) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

8.2 Pjesëmarrja e Ortakëve Themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emri</i>	<i>Numri i kuotave</i>	<i>Pjesëmarrja në përqindje (%)</i>	<i>Vlera totale e kontributit (Euro)</i>
1.	Anchor Investments sh.p.k.	1	51%	510.000
2.	J - Coils sh.p.k.	1	49%	490.000

8.3 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

8.4 Kapitali i shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta).

8.5 Ortakët e shoqërisë përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

8.6 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve kapitali mund të ndryshojë sipas formave të parashikuara nga ligji.

Neni 9 Transferimi i kuotave

9.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributeve në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

9.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

9.3 Çdo transferim i kuotave tek të tretët bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke redaktuar dhe akt noterial per transferimin e kuotave.



4

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

10.1 Shoqëria mund të rrisë Kapitalin Themeltar në para ose në natyre (pasuri të paluajtshme apo të luajtshme) ose mund ta zvogëlojë atë por jo në kufirin minimal që lejohet nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, për këtë lloj shoqërie.

11.1 Shtimi ose zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

11.2 Dokumenti depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit e cila bën ndryshimet përkatëse.

Neni 11

Organet e Shoqërisë

11.1 Asembleja e Ortakëve

Organi vendimarrës dhe drejtues i Shoqërisë është Asembleja e Ortakëve.

(i) - Ortakët janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimin e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimit të administratorit;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujditorëve;
- e) Përcaktimin e shërbimit për personat e përmendur në pikat c dhe d të kësaj pike, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f) Miratimin e pasqyrave vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratës;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Çështje të tjera të parashikuara në ligj;

(ii) - Ortakët e shoqërisë marrin vendime për çështje të percaktuara në pikën 1), të këtij neni pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatëse.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen dhe në këtë regjistër duhet të regjistrohen:


- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) investimet;
- d) vendimet për riorganizim dhe prishjen e Shoqërisë.

11.2 Administrimi

(i) Administratori i vetëm i shoqërisë “ANCHOR BETON” sh.p.k. me një afat 5 (pesë) vjeçar emërohet **Z. Enrik Filto**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me 30.05.1981, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I10530067T.

(ii) Administratori i Shoqërisë, z. Enrik Filto ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e lejuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi si edhe pa asnjë limit veprime bankare në emër të shoqërisë.

(iii) Asembleja e Ortakëve mund të emërojë një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë pa qenë ortakë të shoqërisë. Afati i emërimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet me të drejtë rripërtëritje.



(iv) Nëse Asambleja e Ortakëve emëron më shumë se një administrator ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Neni 12

Të Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

- a) Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare.
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare.
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- ç) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim.
- d) Kryen regjistrimin e dergon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe ndryshimeve të tij.
- dh) Raporton përpara Asamblesë së Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- e) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- ë) Administratori gjatë kryerjes së detyrës së tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e shoqërisë me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës veprimit ose mosveprimit është kryer në mirëbesim.
- f) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe ligjin është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo çdo person tjetër i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta (në përputhje me nenin 98), pika 4)e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”).
- g) Në interesin e mirë të shoqërisë në tërësi administratori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
- gj) Të ushtrojë kompetenca që lidhen me ligjin dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- h) Të vlerësojë me përgjegjësi çështje të tjera për të cilat merret vendimi.
- i) Të parandalojë dhe mënjanjojë raste konflikti prezent ose të mundshme të interesave personale me ato të shoqërisë.
- j) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

KREU II

DREJTIMI EKONOMIK

Neni 13

Viti Financiar

13.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

13.2 Përjashtim bën Viti i parë financiar i shoqërisë i cili fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividenti

14.1 Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Asamblesë së Ortakëve miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.



14.2 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit pasi të jetë zbritur humbja e vitit të mëparshëm financiar siç parashikohet në ligj.

Neni 15

Ekspertët

15.1 Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e **Asamblesë së Ortakëve**.

15.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë Asamblesë së Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e së drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Bilanci Kontabël

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga Asambleja e Ortakëve e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

Neni 17

Dividenti

Të ardhurat neto (dividenti) që mbetet pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërm dhe atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treta i mbesin dhe kalojnë në pronësi të Ortakëve të shoqërisë.

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohe dhe për çfarëdo shkakku edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jenë:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një mënyrë të parashikuar në ligjin "Për falimentin e Shoqërive Tregtare"
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare

Në këto raste Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likuiditorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiditorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëria në likuidim e sipër".

Neni 19

Bashkimi dhe ndarja

19.1 Shoqëria me anë të bashkimit mund ti kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

19.2 Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund ti kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

19.3 Ortaku që bën kalimin e trashëgimisë së tij në kuadrin e operacioneve të përmendura më lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit



një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10% të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhënë.

19.4 Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen nëpërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Neni 20

Afati i emërimit të Likujdatorit publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentin që duhet depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 21

Likujdatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektin ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

Neni 22

22.1 Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj z. Enrik Filto.

22.2 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për shoqërinë.

Neni 23

23.1 Shoqëria përgjegjëse për kontributet fiskale afatet e derdhjes së tij sigurimet shoqërore etj.

23.2 Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë Bankave të vendit dhe të kryejë veprimet likujduese nëpërmejet tyre.

Neni 24

24.1 Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose në valutë të huaj.

24.2 Shkëmbimet e monedhës shqiptare në monedhë të huaj dhe anasajelltas mund të bëhen në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shqipërisë ose tregut të lirë privat të valutës.

Neni 25

Për pasqyrimin e aktivitetit administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas ligjit dhe kërkesave ligjore.

KREU III **MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT**

Neni 26


Asambleja e Ortakëve vendos për shtimin ose pakësimin e numrit të ortakëve dhe personave të tjerë të punësuar në veprimtarinë e Shoqërisë.

Neni 27

Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis paleve në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 28

Marrja në punë bëhet nga punëdhënësi në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 7961, datë 12 Korrik 1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 - Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i



8

ndryshuar”, duke bërë regjistrimin në Regjistrin e të punësuarve të shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e Zyrës së Punës dhe të Inspektoriatit Shtetëror në juridiksionin ku ushtron aktivitetin shoqëria.

Neni 29

29.1 Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga administratori. Largimi lidhet me dakordësi ndërmjet Palëve, me mbarimin e Kontratës së Punës, për shkak të shkeljeve disiplinore ose me vetë kërkesën e të interesuarit.

29.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve të cilat mund të caktojnë një përfaqësues me prokurë për ti përfaqësuar.

29.4 Kur mirëkuptimi nuk është i mundur palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen gjyqësisht.

KREU IV DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 30

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe çfarëdo tjetër akti ligjor e nënligjor specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 31

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve do të jenë kompetente Gjykatat Shqipëtare.

Neni 32

Dispozitat Përfundimtare


Ky statut u përpilua në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë themeluese “ANCHOR BETON” sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin, firmat dhe vulat përkatëse mbi origjinalet.

ASEMBLEJA E ORTAKËVE

Shoqëria Anchor Investments sh.p.k.

Administratori

z. Albi Shyti



Shoqëria J - Coils sh.p.k.

Administratori

z. Jak Bushi

